



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 1001 / Prot. / (E.M./A.K.)
2

Tiranë, më 18.01 2024

Lënda: Dërgohet vendim mbi kërkesën tuaj

Drejtuar: Sali BERISHA

Adresa: Rruga "Mustafa Matohiti", Ndërtesa Nr.36, Hyrja Nr.1, Njësia Bashkiake Nr.2

TIRANË

Bashkalidhur, ju dërgojmë vendimin datë 18.01.2024, mbi kërkesën tuaj me nr. 1001 prot. datë 15.01.2024 (hyrje në prokurori), në kuadrin e procedimit penal nr. 287 të vitit 2020.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

VENDIM

PËR KËRKESAT E PALËVE

Në Tiranë, më datë 18.01.2024, ne **Arben Kraja** dhe **Enkeleda Millonai**, prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, pasi studiuam procedimin penal nr. 287 të vitit 2020,

KONSTATUAM:

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, ka regjistruar procedimin penal të mësipërm, në kuadër të të cilit, rezulton i regjistruar si person nën hetim edhe shtetasi Sali Berisha, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 e 25 i K.Penal.

Me vendimin nr. 112 datë 20.10.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, ka pranuar kërkesën e prokurorisë, duke caktuar për personin nën hetim Sali Berisha, masat e sigurimit personal “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe “*Ndalim i daljes jashtë shtetit*”, parashikuar nga neni 233 i K.Pr.Penale.

Me vendimin nr. 117 datë 26.10.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, ka vendosur ndër të tjera, vazhdimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, e parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr. 112 datë 20.10.2023 ndaj personit nën hetim Sali Berisha duke u urdhëruar ky i fundit të paraqitet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10.00 para oficerit të policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe urdhërimi i këtij shtetasi të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233 pika 1 të K.Pr.Penale dhe ndalimi i përdorimit të pasaportës dhe dokumentave të tjera identifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit.

Duke mos qenë dakort me dy vendimet e mësipërme, nga ana e personit nën hetim dhe mbrojtësve të tij është ushtruar ankimi. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, me vendimin nr. 56 datë 21.11.2023, ka vendosur ndër të tjera miratimin e vendimit nr. 112 datë 20.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të verifikuar me vendimin nr. 117 datë 26.10.2023 të së njëjtës gjykatë, ndaj ankuesit Sali Berisha.

Neni 232 i K.Pr.Penale, paraqet diapazonin e masave të sigurimit shtrënguese, ku ndërmjet tyre edhe atë të arrestit në shtëpi. Masa e sigurimit “*arrest në shtëpi*”, parashikuar si e tillë në mënyrë më të hollësishme nga neni 237 i K.Pr.Penale, konsiston, pikërisht, në detyrimin e personit nën hetim, për të qëndruar në një vend të caktuar, konkretisht banesës së tij, moslargimit nga kjo banesë ose vendi i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistencë. Kur cakton këtë masë, gjykata përcakton edhe mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së saj.

Në rastin konkret, Gjykata me vendimin e sipërcituar, ka disponuar “...*Urdhërohet shtetasi nën hetim Sali Berisha, të mos largohet nga banesa e tij e ndodhur në adresën: Rruga “Mustafa Matohiti”, Ndërtesa 36, hyrja 1, Nd 036, Njësia Administrative nr. 2 Tiranë, si dhe të mos komunikojë me persona të tjerë përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të...*”.

Në vijim, neni 237 i K.Pr.Penale, në pikën 4 të tij, parashikon se për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejné rregullat e caktuara për paraburgimin dhe në pikën 5 sanksionon se koha e qëndrimit në arrest në shtëpi llogaritet në caktimin e dënimit. Pra, referuar ashpërsisë që mbart kjo masë, ajo gjen përputhje në disa elementë, me masën më ekstreme, që është “*arrest në burg*”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

Ndodhur në këto kushte, edhe e drejta për të ushtruar profesionin, apo qoftë edhe mandatin e fituar nga zgjedhjet për në Kuvend, duhet të konsiderohet si e papajtueshme me zbatimin e masës së sigurimit “*arrest në shtëpi*”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ashtu siç është e papajtueshme edhe për çdo qytetar tjetër që i nënshtrohet kësaj mase, e drejta për të shkuar në punë.

Në rastin e masave të tjera shtrënguese, siç është detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, konstatohet se e drejta për të ushtruar profesionin, është në përputhje me llojin e masës, pasi personi nuk detyrohet të qëndrojë në banesën e tij.

Lloji i masës shtrënguese, vendoset nga gjykata, duke mbajtur parasysh kushtet dhe kriteret që kërkohen për caktimin e tyre apo respektimi i detyrimeve të tjera që lidhen me një masë sigurimi. Aplikimi i masës së sigurimit të arrestit në shtëpi, do të thotë se nevojat për sigurim dhe mbarëvajtje të procesit penal, nevojat për të cilat është vlerësuar të vendoset kjo masë, janë më të mëdha e më të domosdoshme, se sa ato të vërtetuara nga llojet e tjera të masave të sigurimit personal.

Ndodhur në këto kushte, nevojat që ka vlerësuar gjykata, mbi bazë të të cilave ka çmuar caktimin e masës së sigurimit “*arrest në shtëpi*”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, duhet të mbizotërojnë, në raport me tagrin e deputetit ndaj të cilit zhvillohen hetime, për të marrë pjesën në punimet e Kuvendit.

Legjislatori, nuk ka parashikuar në asnjë nga dispozitat e K.Pr.Penale apo në dispozitat e ligjit nr. 81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarëve me burgim dhe të paraburgosurëve*” mundësimin e dhënies së një leje të tillë. Madje, edhe siç mund të konstatohet nga vetë kërkesa e paraqitur nga

personi nën hetim, nëpërmjet mbrojtësit av. Sokol Mëngjesi, nuk evidentohet asnjë dispozitë mbi të cilën të mbështetet kërkesa për dhënien e kësaj leje.

Edhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj nr. 17/5 datë 09.11.2015 është shprehur: "...Leje, e cila në vetvete për nga natyra e saj, sidomos për nga kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria thuhet e pandërprerë sipas kalendarit të punimeve të Kuvendit, dhe për nga moria e veprimtarive kuvendore do të zbehte pothuajse krejtësisht qëllimin dhe objektin e vendimit për caktimin e masës së sigurimit. Në Kodin e Procedurës Penale nuk identifikohet ndonjë dispozitë ligjore që të parashikojë mundësinë e dhënies së një leje të një natyre të tillë, kurse dispozitat e parashikuara në ligjin për trajtimin e të paraburgosurve, natyra e lejeve që mund të kërkohen ka karakter rastësor dhe të përjashtimor, pra nuk parashikohet as në ligjin nr.8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" ndonjë dispozitë që të mbështeti pretendimin e personin nën hetim. Në këto kushte, e drejta kushtetuese për të ushtruar funksionin e deputetit, nuk mund të konsiderohet si mbizotëruese në raport me përmbushjen e interesit kushtetues që ka të bëjë me plotësimin e nevojave për mbarëvajtjen e procedimit penal lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor që synon përcaktimin e së vërtetës lidhur me akuzat e ngritura dhe çështjen e përgjegjësisë penale. ...".

Në rast se legjislatori do të kishte për qëllim që deputetit nuk duhet në asnjë mënyrë t'i ndërpritet mundësia për të marrë pjesë në punimet e Kuvendit, atëherë do të kishte bërë parashikime të tjera si në Kushtetutë ashtu edhe në ligjin procedural penal. Kjo gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Ndodhur në këto kushte, vlerësohet të mos pranohet kërkesa e paraqitur nga personi nën hetim Sali Berisha, nëpërmjet mbrojtësit të tij av. Sokol Mëngjesi për lejimin e marrjes pjesë në seancat plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Përsa më sipër, mbështetur në nenin 110 të K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë M

1. Mospranimin e kërkesës me nr. 1001 prot., datë 15.01.2024 (hyrje në prokurori), të personit nën hetim Sali Berisha, paraqitur nëpërmjet mbrojtësit të tij, av. Sokol Mëngjesi.
2. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet për dijeni personit nën hetim Sali Berisha dhe avokatit të tij Sokol Mëngjesi.

PROKURORË

ARBEN KRAJA ENKELEDA MILLONAI

